

**Data 16.09.2024**

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROKURIMIT:**

**Rikonstrukcion i ambjenteve sportive dhe shkollës Nepravishtë Bashkia Libohovë**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**Punë ndërtimi 45100000-8**

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 35 191 412 (tridhjetë e pesë milion e njëqind e nëntëdhjetë e një mijë e katërqind e dymbëdhjetë) lekë, pa TVSH.

2. Në rastin kur, objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, shumatorja e çmimeve për njësi

është

3. Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit me 29 960 324 lekë pa TVSH dhe Buxheti i Bashkisë Libohovë me 5 231 088 lekë pa TVSH.

Shënim:

Kjo kontratë është bashkëfinancim dhe likuidimi i kontratës dhe do të shtrihet në dy vite si më poshtë:

1 -Ministria e Arsimit dhe Sportit: 29 960 324 (njëzet e nëntë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë e treqind e njëzet e katër) lekë pa Tvsh nga Granti i cili ndahet:

- Për Vitin 2024: 29 166 666 (njëzet e nënte milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtë dhjetë e gjashtë) lekë pa Tvsh nga Granti

- Për Vitin 2025 :793 658 (shtatëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë pa Tvsh nga Granti

2- Bashkia Libohovë për vitin 2024 : 5 231 088 (pesë milion e dyqind e tridhjetë e një mijë e tetëdhjetë e tetë ) lekë pa Tvsh nga buxheti bashkise me Vendim te Keshillit Bashkiak Nr.21 dt. 19.04.2024

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Gjirokastër ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;*
- b. *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës ....*
- c. *Formular oferte*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021-2022-2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur të kontratës

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Neni 55 pika 4 paragrafi II

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar eshte bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku percaktohet se: ” Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.*

---

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021-2022-2023 paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika ”c”, te ligjit nr.10091 date 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 25/2018 ”Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe neni 41, pika ”c”, e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar.

**2.2.3** Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023 dhe kestin perkates te maturuar per vitin 2024, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar) për të gjitha adresat ku operatorët ushtrojnë aktivitetin e tyre sipas të dhënave të ekstraktit të QKB- së historik.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

*(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit; dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlloritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

### **Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten :**

1. Kontrate sipermarrjeje ;
2. Situacionin përfundimtar;
3. Akt kolaudimi;
4. Fatura tatimore per situacionin përfundimtar
5. Certifikatë e marrjes në dorëzim e perkohshme ose përfundimtare

### **Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten**

1. Kontrate sipermarrjeje ;
2. Situacionin përfundimtar;
3. Akt kolaudimi;
4. Fatura tatimore per situacionin përfundimtar

***Pika 2.3.1 a) plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.***

***Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.***

Shenim: Per punet e ngjashme te realizuara si BOE krahas dokumenteve te mesiperme duhet te paraqitet edhe kontrata e bashkepunimit ku percaktohet ndarja e zerave te punimeve ndermjet paleve, ndersa per punet e ngjashme te realizuara si nenkontraktor duhet te paraqitet edhe kontrata e nenkontraktimit ku percaktohen zerat e punimeve dhe miratimi i autoritetit kontraktor/investitorit

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit e kontratës që prokurohet , për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

**Shënim:** (Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi).

**2.4** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministri e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e Vkm nr 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit , klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

**Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :**

- N.P 1 – A Punime gërmimi në tokë
- N.P 3 – B Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash
- N.P 7 – A Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje
- N.P 12 –B Punime të inxhinierisë mjedisit

**Për punimet speciale të ndërtimit :**

- N.S 1 – A Punime për prishjen e ndërtimeve
- N.S 2 – A Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre
- N.S 4 – B Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese
- N.S 12 – A Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit
- N.S 13 – A Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni
- N.S 14 – A Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV etj

*Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues*

**2.3.2/1** Kategoritë e mëposhtme:

Nr.	Licensa	Kategoria e kryerjes së punimeve
1	N.P 1-A	Punime gjurmimi në tokë
2	N.P 3-B	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash
4	N.P 7-A	Ujësjiellës, gazsjiellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje
5	N.P 12-B	Punime të inxhinierisë mjedisore
6	N.S 1-A	Punime për prishjen e ndërtimeve
7	N.S 2-A	Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre
8	N.S 4-B	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese
9	N.S 12-A	Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit
10	N.S 13-A	Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni
11	N.S 14-A	Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV

*Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.*

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Gjithashtu, të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, Ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, Neni 8 përcakton “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për*

*zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane”.*

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P 1-A	Punime gjermimi në tokë	Gjermim eper sistemimin e jashtem	0-20 mln	152,991.00
N.P 3-B	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash	Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.	101-200 mln	35,292,034.44
N.P 7-A	Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje	Punime kanalizimi ujera te zeza	0-20 mln	649,299.61

N.P 12-B	Punime të inxhinierisë mjedisore	Punime mjedisore per sitemimin e jashtem	21-50 mln	746,982.85
N.S 1-A	Punime për prishjen e ndërtimeve	Punime prishje + puni prishje territori	0-20 mln	1,627,275.37
N.S 2-A	Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre	Punime shtresash ne tualete; aparate hidrosanitare; furnizimi me uje	0-20 mln	652,403.32
N.S 4-B	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese	Punime catie, murature, shtresash, suvatim bojatisje jashte dhe brenda, dyer dritare	21-50 mln	14,689,053.00
N.S 12-A	Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit	Instalim kaldaja dhe punime per rrjetin ngrohes	0-20 mln	2,950,027.10
N.S 13-A	Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni	Linja telefonie dhe interneti	0-20 mln	28,244.57
N.S 14-A	Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV	Panele te matjes se perqendruar te energjise elektrike, rrjetit e lektrik, kuader elektrik, rrjeti elektrik I ndricimit t klasava, linjat e furnizimit elektrik te ambjentit teknik (kaldaja), sistemi I mbrojtjes atmosferik dhe tokezimi	0-20 mln	1,374,338.74



*(Shënim: përcaktoni kategoritë e nevojshme të licencës, me emërtimin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës, duke përcaktuar edhe nivelin minimal të klasifikimit për çdo kategori, sipas vlerave të punimeve konkrete që do kryhen, si dhe institucionin që lëshon këtë licencë).*

**2.5** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- **1 (nje) Arkitekt**
- **1 (nje) Inxhinier Ndertimi**
- **1 (nje) Inxhinier Mekanik**
- **1 (nje) Inxhinier Elektrik**
- **1 (nje) Inxhinier Elektronik**
- **1 (nje) Inxhinier Mjedisi**
- **1 (nje) Inxhinier Hidroteknik**
- **1 (nje) Inxhinier Gjeodet**

Secili prej pjesëtarëve të drejtuesve teknik të mësipërm duhet të jetë në listëpagesat e muajit Qershor 2024- Gusht 2024 si dhe të figurojnë në licencën e shoqërisë.

Për secilin prej tyre duhet të paraqitet :

- Kontratë pune e vlefshme
- Diploma
- CV

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punonjësit që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor I kërkon ofertuesit të kualifikuar, I pari dorëzimin e dokumenteve provuese si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

***Argumentimi:*** Në bazë të pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

*Kriteri për stafin drejtues teknik lidhet ngushtësisht objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Inxhinierët janë përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të pasur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.*

*Drejtuksi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.*

**2.6** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur me licensë lëshuar nga QKL “Për grumbullim, ruajtje dhe transportim të mbetjeve urbane “Kodi III.2.B” (Për grumbullim, ruajtje dhe transportin e mbetjeve urbane), së bashku me aktin e miratimit nr 5

*Argumentim:*, Neni 77, pika 4, në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 8, si dhe nenit 44

**2.7** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojëfuqi punëtores prej **minimalisht 70 persona** të cilët duhet të jenë pjesë e listëpagesave të muajit Qershor 2024- Gusht 2024

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikëduhet të vetëdeklarojnëdisponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor I kërkon ofertuesit të kualifikuar, I pari dorëzimin e dokumenteve provuese si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

***Argumentim:** Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.*

*Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje **e përcaktuar**, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtores të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomikë, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim **të paktën 70 persona**, duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t'i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë,*

*kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

*Analizat teknike janë bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar në katër elementët e strukturës së kostos (material, punëtori, makineri, transport) zëri fuqi punëtore zë rreth 20% të kostos.*

**2.8** Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë)**, si më poshtë:

- **1 (nje) Inxhinier Ndertimi**
- **1 (nje) Inxhinier Elektrik**
- **1 (nje) Inxhinier Gjeolog**

Secili prej punonjësve të mësipërm duhet të jetë në listëpagesat e muajit Qershor 2024- Gusht 2024.

Për secilin prej tyre duhet të paraqitet :

- Kontratë pune e vlefshme
- Diploma
- CV

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punonjësit që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor I kërkon ofertuesit të kualifikuar, I pari dorëzimin e dokumenteve provuese si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin*

### **Stafi i kërkuar në pikën 2.8 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera**

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe Nenit 39, pika 6/c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin mbështetës lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

**2.9** Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/ të kualifikuar**, si më poshtë duhet të jetë në listëpagesat e muajit Qershor 2024- Gusht 2024

- Teknik ndertimi – jo me pak se **2 (dy)** punonjes
- Suvatues – jo më pak se **10 (dhjete)** punonjës
- Termoizolues/Hidroizolues – jo më pak se **10 (dhjete)** punonjës
- Hidraulike – jo më pak se **2 (dy)** punonjës
- Elektracist – jo më pak se **2 (dy)** punonjës
- Instalues sisteme ngrohese - jo më pak se **2 (dy)** punonjës
- Pllakashtrues – jo me pak se **6 (gjashte)** punonjes
- Bojaxhi – jo më pak se **2 (dy)** punonjës
- Karpentier – jo me pak se **1 (nje)** punonjës
- Hekurthyes – jo me pak se **1 (nje)** punonjës

Punonjësit e mësipërm të jenë të pajisur me deshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose ekuivalente me to të akredituara nga legjislacioni në fuqi si dhe të paraqitet kontratë pune e vlefshme.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punonjësit që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

*Gjithashtu OE, duhet të plotësojnë tabelën në vijim:*

<b>Nr.</b>	<b>Emër Mbiemër i punonjësit</b>	<b>Profesioni</b>	<b>Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës</b>	<b>Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)</b>
1				
2				
etj				

Për secilin punonjës, duhet të paraqesë dokumentacionin: kontrata e punës e vlefshme, dëshmi/çertifikatë kualifikimi të lëshuara nga institucione publike/ private të licensuara për kurset e ofruara, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” për specialistët, ndërsa për teknikët duhet të paraqiten diplomat e shkollës së mesme, si dhe të figurojnë detyrimisht në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Qershor 2024- Gusht 2024 Të gjithë punonjësit e përmendur me sipër duhet të jenë të përfshirë në listëpagesat E-Sig të punonjesve për periudhën e kerkuar, sipas kodeve të profesioneve të miratuara në VKM 514 date 20.09.2017 ”Për miratimin e listës kombetare të profesioneve (LKP) të rishikuar

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor I kërkon ofertuesit të kualifikuar, I pari dorëzimin e dokumenteve provuese si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

*Argumentimi: referuar natyrës, dhe përmasave/ volumit të punimeve që përmban objekti i prokurimit, **me qëllim vërtetimin e aftësisë zbatuese të kontratës**, njësia e prokurimit vlerëson se, operatorët ekonomik duhet të disponojnë stafin mbështetës për kryerjen e të gjitha punimeve objekt prokurimi, si: **Teknik ndërtimi**, ku krahas dokumentave të tjera të kërkuara, është e rëndësishme që për vërtetimin e aftësive të tyre, të paraqiten diplomat e shkollës së mesme. Gjithashtu krahas teknikëve, referuar natyrës, specifikës dhe volumit të punimeve që do të kryhen, për realizimin e tyre në përputhje me standartet teknike të zbatimit dhe brenda afatit të përcaktuar, njësia e prokurimit vlerëson të nevojshëm disponimin e **punonjësve të kualifikuar, të cilët duhet të jenë me specialitetin: Murator, Suvatues, termoizolues, Hidraulik, elektrikiste, instalues sisteme-ngrohese, pllakashtrues, konstruktor te strukturave metalike, Saldator, Bojaxhi, pasi pa këto punonjës nuk mund të kryhen/ realizohen punimet objekt kontrate prokurimi**, ku për vërtetimin e disponimit të tyre është kërkuar plotësimi dhe paraqitja e të dhënave sipas tabelës të përcaktuar, dhe paraqitja e dokumentacionit, dëshmitë/ certifikatat e kualifikimit të lëshuara nga institucione publike/ private të licensuara për kurset e ofruara, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” për vërtetimin se këto punonjës janë të kualifikuar për kryerjen e punimeve objekt kontrate, si dhe kanë njohuri për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik në punë në lidhje kryerjen e punimeve, përdorimin e mjeteve, marrjen e masave mbrojtëse etj., **në zbatim të Rregullores së Sigurimit teknik për punën në ndërtim**, si dhe të figurojnë të punësuar në listëpagesat e shoqërisë*

**2.10** Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/ të kualifikuar**, si më poshtë:

- 1 (një) punonjës i pajisur me certifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- 1 (një) punonjës që disponon certifikatën si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e Ligjit nr. 10327, datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M-së nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

**Stafi i kërkuar në pikën 2.10 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera.**

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor I kërkon ofertuesit të kualifikuar, I pari dorëzimin e dokumenteve provuese si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të Nenit të 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

*Kërkesa e mësipërme mbështetet në Ligjin nr. 10327, datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", si dhe Ligjit nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.*

*Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmën e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.*

*Operatori/ët ekonomik/ë që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentet përkatëse lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës*

**2.11** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar minimumi dhe 3 (Tre) manovratorë/automakiniste/eskavatorise/buldozeriste, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesa të shoqërisë të punësuar për periudhën Qershor 2024- Gusht 2024 në rastin kur mjetet/makineritë e deklaruar janë në pronësi të operatorit ekonomik ofertues, në të kundërt kur mjetet/makineritë disponohen me qera, ky staf i kërkuar mund të jetë i kontraktuar, dhe në çdo rast, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin të paraqiten:

- Kontratë pune të vlefshme,
- Dëshmi kualifikimi nga organet përkatëse sipas ligjit,

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetë deklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor I kërkon ofertuesit të kualifikuar, I pari dorëzimin e dokumenteve provuese si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin*

**Argumentimi:**

Gjithashtu, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet që të paraqesin dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar për disponimin në stafin e tyre, e të paktën **5 (pesë)** manovratorë/automakinist/eskavatraste/buldozeriste, të cilët duhet të disponojnë dëshmitë e nevojshme për drejtimin e mjeteve të rënda të kërkuara, me qëllim transportimin e materialeve dhe inerteve si dhe gërmimeve për kryerjen e punimeve objekt kontrate, pasi pa këto mjete nuk mund të kryhen punimet objekt kontrate. Në përcaktimin e numrit të punonjësve shoferë dhe manovratorë, është përcaktuar duke patur parasysh volumin e punimeve që do të kryhen përfshirë dhe transportin e materialeve dhe inerteve, si dhe sasinë dhe llojin e mjeteve që nevojiten për kryerjen e punimeve objekt kontrate.

**2.12** Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë **1 (një) mjek të përgjithshëm**, ku për përmbushjen e këtij kushti operatori ekonomik ofertues duhet ta deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin: Kontratë të vlefshme pune/ kontratë shërbimi mjeku, Urdhër mjeku, dhe Diplomë.

*Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve ekonomik pjesëmarrës në bashkim që plotëson kriteret e VKM-së Nr.108, datë 09.02.2011 i ndryshuar me VKM-në Nr.632, datë 15.07.2015, duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm*

**2.13** Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një **deklaratë** (nga Administratori i shoqërisë) **Drejtuesin Teknik të punimeve** (*Inxhinier Ndërtimi me eksperiencë*) në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt dhe *nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.*

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.*

*“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, si më poshtë: **Diplomë, Librezë pune dhe kontratë pune***

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e

*Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në ndërtim” e ndryshuar me Ligjin nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa” me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të përcaktojnë Drejtuesin Teknik që do jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës në objekt.*

**2.14** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr.	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10 - 15 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
2	Kamion me vinc	në pronësi ose me qira	Copë 1
3	Kamioncine deri ne 5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
4	Eksavator me goma ( mjet teknologjik me goma)	në pronësi ose me qira	Copë 3
5	Fadrome me goma ( mjet teknologjik me goma)	në pronësi ose me qira	Copë 1
6	Autobetoniere	në pronësi ose me qira	Copë 1
7	Autopompë	në pronësi ose me qira	Copë 1
8	Damper ( mjet teknologjik me goma)	në pronësi ose me qira	Copë 2
9	Pompë Suvatimi	në pronësi ose me qira	Copë 2
10	Grejder ( mjet teknologjik me goma)	në pronësi ose me qira	Copë 1
11	Matrapik	në pronësi ose me qira	Copë 2
12	Autobetoniere me kapacitet 2.5-3.5m3( mjet teknologjik me goma)	në pronësi ose me qira	Copë 1
13	Makineri për shperndarrjen <u>uniforme</u> të kokrizave të gomës të barit artificial	në pronësi ose me qira	Copë 1
14	Minifadrome ( mjet teknologjik me goma)	në pronësi ose me qira	Copë 1
15	Mjet multifunksional teleskopik (pirun + vinc) me krah mbi 10 m / vinç eskavator	në pronësi ose me qira	Copë 1
16	Nyje inerte	në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi	Copë 1

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme), taksen vjetore dhe per mjetet e siguruara me qera, dokumenti qe verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit,(te vlefshme) duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qerases, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.

c) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.



d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

e) Makinat e transportit **te shoqerohen gjithashtu edhe me Leje te Transportit te Mallrave(te vlefshme),leshuar nga organet kopetente ne emer te shoqerise apo subjektit pronar te mjetit ,ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.**

f)Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojë dhe kontrollojë ne çdo kohe deri ne perfundimin e kontrates mjetet e pajisjet teknik

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor I kërkon ofertuesit të kualifikuar, I pari dorëzimin e dokumenteve provuese si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4 të Nenit të 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).

**2.15** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, ose ekuivalente konkretisht:

- a) **ISO 14001:2015** Sistemet e menaxhimit te ambientit / **ekuivalente dhe e vlefshme**
  - b) **ISO 9001:2015**, mbi “Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, **ekuivalente dhe e vlefshme**
  - c) **ISO 45001:2018**, mbi “Sistemin e Menaxhimit te Shëndetit dhe sigurise në punë”, **ekuivalente dhe e vlefshme**
- Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për

*të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Nenit 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se:*

*“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

## **2.16 Grafiku i punimeve.**

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 79 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenin 39, pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

**2.17 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratën ku të shprehet se është dakord me mënyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor (në rast të shpalljes fitues).**

*Paraqitja e kësaj deklarate është kërkuar, pasi burimi i financimit për këtë procedurë është Buxheti i Shtetit, e përcaktuar edhe në Dst . Financimi është parashikuar në buxhetin 2024-2026, edhe pse afati i realizimit është sipas grafikut të punimeve.*

AK do të bëjë verifikimet e dokumentacionit ne perputhje me vetedklarimet e bëra në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit në përputhje me Nenin 26, pika 7 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht për skualifikim.

Sqarim

AK për të bërë sa më të thjeshtë procesin e verifikimit të gjendjes gjyqësore për anëtarët e organit administrativ, drejtuesit ose mbikqyrësit aksionerit ose ortakut ose ka kompetenca përfaqësuese , vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik këkon nga ana e operatorëve ekonomik për të deklaruar ID e personave të cilët do të deklarohen në Shtojcën 9 të Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit për këtë verifikim.

**-Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.**

**-Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur**

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**